

## Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019. (Te gjitha balancat jane ne leke).

### 1. Informacione te pergjitheshme

"Power Industries" sh.p.k, eshte regjistruar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me NIPT L51706022H regjistruar me 05 Maj 2015. Kapitali i regjistruar eshte 112 400 000 leke dhe zoterohet nga ortaket themelues, Olta Xhaferi nje kuote 50 % e Kapitalit dhe Maksim Shena nje kuote 50 % e Kapitalit. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per vitin ushtrimor 2019 ish te ne: Ushtrim i veprimtarise: Tregtimi i te gjitha llojeve te mallrave, materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhire te tipeve te ndryshme, makinerive, pajisjeve dhe impjanteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregtar, kulturor, sportiv, sherbimeve pjese kembimi, goma te ndryshme, bateri automjetesh.

#### Permbledhje e politikave dhe parimeve kontabel

- **Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare (PF) jane pergatitur ne perputhje me ligjin nr. 9228 dt 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Kombetare te Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente te metodave te tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. PF-te paraqiten ne monedhen vendase, Lek Shqiptar (lek).

- **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit te drejtave te konstatuara. Njesia ekonomike mat te ardhurat me vleren e drejte te arketuar ose te arketueshme. Vlera e drejte e shumes se arketuar apo per t'u arketuar merr parasysh shumen e cfaredo zbritje tregtare, zbritjet per shlyerje te menjehershme dhe zbritjet e bera per sasi (vellim) te blere. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

- **Monedhat e huaja**

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne leke, me kursin zyrtar te kembimit te Bankes se Shqiperise ne daten e kryerjes se transaksionit kur nuk jepet ndryshe. Zerat jomonetare, te shprehur ne monedhe te huaj, maten ne termat e koston historike dhe nuk rivleresohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve te kembimit njihet ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfishrese.

Kurset e kembimit, te perdorura nga shoqeria per monedhat e huaja me kryesore, ne dt 31.12.2019 jane:  
1 EUR=121.77 LEKE  
1 USD=108.64 LEKE

- **Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqeson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar qe raportohet ne pasqyren e performances, sepse korigjohet me shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin te thjeshtuar per ushtrimin 2019 eshte 15 %.

- **Kerkesat per t'u arketuar**

Kerkesat per t'u arketuar, te ardhurat e konstatuara dhe llogari te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u arketuar ne para regjistruhen ne bilanc me kosto te amortizuar. Kostoja e amortizuar e kerkesave per t'u arketuar afatshkurtra, ne pergjithesi eshte e barabarte me vleren e tyre nominale (minus provizionet e krijuara per renie ne vlere), keshtu qe kerkesat afatshkurtra regjistruhen ne bilanc me vleren e tyre neto te realizueshme (e cila raportohet, per shembull ne nje fature, kontrate ose dokument tjeter).

- **Pasivet financiare**

Huate e marra, furnoret, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u shlyer ne para, ne pergjithesi, mbahen me koston e amortizuar ne bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, ne pergjithesi, eshte e barabarte me vleren e tyre nominale, keshtu qe pasivet financiare afatshkurtra mbahen ne bilanc ne vleren e tyre neto te realizueshme (per shembull, te raportuar ne nje fature, kontrate ose dokument tjeter).

- **Aktivet e qendrushme te trupezuara**

Aktivet afatgjata materiale(AAM) bazohen ne modelin e koston. Ne bilanc, nje element i AAM-se paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar minus humbjet e akumuluar nga zhvleresimi. Nese vlera kontabel e nje

# Shoqeria "Power Industries" sh.p.k Pasqyrat Financiare 2019

aktivi afatgjate material rritet, si rezultat i rivleresimit, kjo rritje kreditohet drejtperdrejt ne kapitalet e veta nen zerin "teprice nga rivleresimi". Nese vlera kontabel e nje aktivi afatgjate material zvogelohet, si rezultat i rivleresimit, ky zvogelim njihet si shpenzim ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve nese ne periudhat paraardhese nuk ka nje teprice nga rivlersimi per kete aktiv. Amortizimi eshte llogaritur sipas klasave te AAM. Normat e amortizimit jane ne perputhje me dispozitat ligjore dhe SKK.

## • Gjendjet e inventarit

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes plus te gjitha shpenzimet per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi, shpenzime keto qe i atribuohen drejtperdrejt blerjes se inventareve. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit, qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto e realizueshme.

## 2. Aktive monetare (likuiditete ne arke dhe banke)

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne daten 31 Dhjetor 2019 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2019
		Në lekë
Llogari bankare në lekë	LEK	1,434,498
Arka në lekë	LEK	0
Shuma		1,434,498

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.

## 3. Te drejta te arketueshme

Te drejta te arketueshme, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 deklarohen si vijon:

Të drejta të arketueshme	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	192,084,731
Nga njësitë ekonomike brenda grupit	0
Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	0
Te drejta te tjera nga aktiviteti i shfrytezimit	312,787,656
Te tjera	8,595,926
Shuma	513,468,313

Nga aktiviteti i shfrytezimit paraqitet gjendja e klienteve ne shumen 192,084,731 Leke  
Llogari / Debitore kreditore te tjere ne vleren 312,787,656 leke tregon: Teprica e debitoreve ndaj shoqerise.

## 4. Inventaret

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe ne fund te ushtrimit paraqiten:

Inventarët	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	0
Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	0
Produkte të gatshme	0
Mallra	17,780,062
Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e maimëri)	0
AAGJM të mbajtura për shitje	0
Parapagime për inventar	0
Shuma	17,780,062

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimit fizik te kryer ne fund te vitit ushtrimor 2019. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

# Shoqëria "Power Industries" sh.p.k Pasqyrat Financiare 2019

Shuma e inventarit të paraqitur në "Mallra për shitje" përfaqëson stokun e mallrave për tu shitur periudhat e ardhshme të vlerësuar me kostot mesatare të blerjes.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur është vlera me e ulet mes kostos së marrjes së inventarit dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevoja për zhvlerësime të tij.

## 5. Aktivët Afatgjatë (AAM)

Gjendja dhe levizjet e aktiveve afatgjatë materiale në pasqyrat financiare paraqiten si vijon:

	Gjendjet dhe levizjet	Pajisje Informative	Të tjera AAGJ	Mjete transporti	Mobilje zyre, etj.	Totali
A	Kosto e AAM-ve më 01.01.2019	1,140,694	1,530,641	3,204,447	7,225,433	13,101,215
	Shtesat	-	-	-	128,601	128,601
	Pakesimet	-	-	-	1,305,494	1,305,494
	Kosto e AAM-ve më 31.12.2019	1,140,694	1,530,641	3,204,447	6,048,540	11,924,322
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2019	293,927	-	1,047,675	2,674,100	4,015,702
	Amortizimi ushtrimit	256,435	-	491,088	809,768	1,557,291
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	298,667	475,382	774,049
	Amortizimi i AAM-ve më 31.12.2019	550,362	-	1,240,096	3,008,486	4,798,944
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2019	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve më 31.12.2019	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2019	846,767	1,530,641	2,156,772	4,551,333	9,085,513
	Vlera neto e AAM-ve më 31.12.2019	590,332	1,530,641	1,964,351	3,040,054	7,125,378
E	<b>Norma e amortizimit të aplikuar</b>	<b>25%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>	

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2019.

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me kostën e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me kostën e tyre minus amortizimin e akumuluar minus humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabel, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efektë fiskale.

## 6. Detyrime afatshkurtra

Huata dhe parapagimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2019 paraqiten si vijon:

Detyrime afatshkurtra	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Titujt e huamarrjes	0
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	0
Arkëtime në avancë për porosi	216,890,175
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (Furnitore)	35,880,392
Dëftesa të pagueshme	0
Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	0
Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	0
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	1,496,958
Të pagueshme për detyrimet tatimore	1,680,145
Të pagueshme ndaj ortakut	0
Të tjera	34,559,489
<b>Shuma</b>	<b>290,507,159</b>

(i) "Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit(Furnitore)" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave dhe sherbimeve, detyrime keto qe gjenden pa u likujduar ne fund te vitit ushtrimor 2019. Shoqeria ka bere rakordime me furnitoret dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

(ii) "Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore" gjendje me 31.12. 2019 ne shumen 1,496,958 leke perfaqeson detyrimin per sigurime Shoqerore dhe Shendetesore te periudhes Dhjetor 2019 ne shumen 103,757 dhe paga te pa likujduara ne shumen 1,393,201 leke

(iii) "Te pagueshme per detyrimet tatimore" perfaqesojne Detyrime per TAP te muajit Dhjetor 2019 ne shumen 18,182 Leke, Tatim mbi fitimin ne shumen 0 leke, per TVSH-ne e pagueshme 1,626,211 leke dhe tatim ne burim 35,752 leke.

## 7. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Hua afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 nuk ka.

## 8. Kapitali dhe Rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me vendimet e depozituara ne QKR. kapitali eshte 112 400 000 leke, i ndare ne 2 kuote me vlere nominale 112 400 000 leke. Kapital ky qe zoterohet 50% nga aksioneri i shoqerise, znj.Olta Xhaferi dhe 50% nga aksioneri z.Maksim Shena.

## 9. Fitimi (humbja) e vitit financiar

### ▪ Te ardhurat

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqiten si vijon:

Të ardhurat	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Te ardhurat nga shitja e sherbimeve	232,017,999
Te ardhurat e tjera	0
<b>Shuma</b>	<b>232,017,999</b>

Te ardhurat nga shitja e mallrave si. Ne shumen 232,017,999 Leke jane vleresuar me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e skontimeve ose rabatet e ofruara, te "zhveshura" nga TVSH-ja. **Ne lidhje me te ardhurat e deklaruar sipas FDP-ve dhe librave ne vitin 2019, te cilat jane 267,519,930 leke, shuma prej 35,731,300 leke jane parapagime te bera nga kliente te ndryshem per parapagime per blerje mallra dhe sherbime nga ana jone, te cilat do te kryhen ne vitin ne vijim.**

### ▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme.

Kostoja e punesimit, Pagat dhe Sigurimet Shoqerore&Shendetesore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Taksat lokale si edhe Taksa e Tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2019 jane treguar ne tabelat vijuese:

## 10. Materiale te konsumuara

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
<b>Shpenzimet e blerjes</b>	<b>0</b>
Gjendja e Mallrave me 01.01.2019	7,226,069
Blerje Gjate Ushtrimit	174,294,888
Gjendja e Mallrave me 31.12.2019	17,780,062
<b>Kosto e mallrave te shitura</b>	<b>163,740,895</b>

## 11. Shpenzime te tjera

Shpenzime te tjera	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Bl.energji,avull,uje	60,648
Blerje te pastokueshme	145,805
Trajtime te pergjithshme	695,669
Qira	2,906,800
Mirembajtje dhe riparime	866,467
Sigurime	274,530
Te tjera	512,500
Personel nga jashte ndermarjes	830,000
Shpenz per koncesione, patenta, licensa dhe te ngjashme	138,300
Transferime, udhetim, dieta	1,827,035
Shpz.postare e telekom.	234,387
Transporte per blerje	4,738,045
Sherbime bankare	260,635
Tatim mbi qark. dhe akciza	26,216
Taksa dhe tarifa vendore	233,803
Taksa e regjistrimit	7,800
Subvencione te dhena (Per termetin e dates 26 Nentor 2019)	113,850
<b>SHUMA</b>	<b>13,872,489</b>

## ▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standardeve.

Te ardhura dhe shpenzime financiare	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	1,243,244
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)	0
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	0
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	(52,947)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	0
<b>Shuma</b>	<b>1,190,297</b>

## ▪ Shpenzime personeli

Kostoja e punes paraqitet si me poshte vijon:

Shpenzime personeli	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
<b>Kosto e punes</b>	
Pagat e personelt	8,035,290
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	1,342,255
<b>Shuma</b>	<b>9,377,545</b>

## ▪ Shpenzimet e Tatimit mbi Fitimin/

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	44,660,076
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	-
1	Amortizime	-
2	Shpezime interesi	-
3	Humbje nga mos arketimi I debitoreve	-
4	Shpenzime page te pa zbritshme	-
5	Gjoba dhe te tjera	-
6	Shpenzime Karburanti	-
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE E VITIT(I+II-III)	44,660,076
	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE PROGRESIVE(III+IV)	44,660,076
V	Shpenzimi i tatim fitimit te thjeshtuar 15%	6,699,011
VI	FITIMI/HUMBJA NETO E USHTRIMIT	37,961,065

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

#### 12. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjeshte formen ligjore te tyre , shoqeria nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura,pervec maredhenieve me oratkun.

#### 13. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates se mbylljes se vitit ushtrimitor.

**Administratori i Shoqerise**

Andi Marku

